

VENDIM
Nr. 279, datë 24.6.2022

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME
KONISPOL SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 24.6.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Konispol sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Ujësjellës-Kanalizime Konispol, me shkresën nr. 54 prot., datë 11.5.2022, dhe plotësimet me shkresën nr. 60 prot., datë 6.6.2022, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU-së, për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit – grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik, për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Konispol, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Konispol ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 13 005 banorë të Bashkisë Konispol;

b) Drejtuesi ligjor i shoqërisë, z. Altier Xhaferri, është diplomuar në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, dega Administrim Publik, në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, në vitin 2009, si dhe Master shkencor “E drejta publike” në Universitetin Mesdhetar në vitin 2018;

c) Drejtues teknik i shoqërisë, z. Mikelo Taka, është diplomuar në *Bachelor* në Inxhinieri Mekanike, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, në vitin 2014 dhe Master profesional në Operacione Industriale dhe Navale, në viti 2018.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Konispol, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Konispol është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol sh.a. me (NUIS L74829801V), në kategoritë:

a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Konispol sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor – Altier Xhaferri;

b) Drejtues teknik – Mikelo Taka.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol sh.a. është Bashkia Konispol.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani